



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 12.1, 24.2 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2011, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim aprovet buxheti i Komunës së Vushtrrisë dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2012, konform Qarkores Buxhetore 2012/02 të MEF-it, dt. 27.06.2011.

Neni 2

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012 është 12,492,512.00 €, prej të cilave për:

- Paga.....7,222,060.00 €.
- Mallra dhe shërbime.....1,062,744.00 €.
- Komunalitë..... 274,750.00 €.
- Subvencione.....109,862.00 €.
- Shpenzime kapitale..... 3,823,095.00 €.
- Githsejt:..... 12,492,512.00 €.**

Neni 3

Të hyrat vetanake të planifikuara.....1,772,000.00 €.

Neni 4

Mjetet financiare të cekura në nenin 2 dhe 3 të këtij vendimi do të sigurohen në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2012/02 të MEF-it në bazë të kufijve të dhënë, Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe aktet tjera që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe organet tjera kompetente.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e Rregullores mbi tatimin e pronës së paluajtshme

Neni 1

Aprovohet Rregullorja mbi tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**